

VENDIM
Nr. 150, datë 10.3.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË GODINËS ADMINISTRATIVE, NË ZONËN E RE PËR
ZHVILLIM TË DETYRUAR, NË FSHATIN VALIAS, BASHKIA KAMZË, DHE
CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE**
(ndryshuar me vendimin e KM-së nr. 447, datë 29.6.2022)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 203 034 301 (dyqind e tre milionë e tridhjetë e katër mijë e treqind e një) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit të godinës administrative, në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë.

2. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2021, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 40 606 860 (dyzet milionë e gjashtëqind e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit të godinës administrative, në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë.

2/1 Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Kamzë për financimin e ndërtimit të godinës administrative, në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, në masën 162 427 441 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e katërqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e dyzet e një) lekë pa TVSH, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama